

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6172
E hënë, 23 nëntor 2020
çmimi 0.40 €

Veliaj i bashkohet nismës
"Liria ka emër, UÇK" | FAQE 2



SPITALET DHE KLINIKAT NË KOSOVË JANË MBUSHUR
ME PACIENTË TË INFETUAR ME COVID-19 | FAQE 4-5

RENDOHET GJENDJA ME COVID NË KOSOVË, NUK RESPEKTOHEN MASAT



Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar të dielën se në 24 orët e fundit, dhjetë pacientë kanë vdekur nga Covid-19 dhe janë regjistruar edhe 707 raste të reja me Covid. Ministri i Shëndetësisë, Armend

Zemaj, së bashku me ushtruesin e dytës së drejtitorit të ShSKUK-së, dr. Saudin Maliqi, gjatë fundjavës ka vizituar klinikat e QKUK-së për ta parë gjendjen sa iu përket hapësirave dhe situatës me barna për trajtim të pacientëve me Covid-19. Zemaj ka

thekuar se spitalet dhe klinikat janë të mbushura me pacientë të infektuar me Covid. Ai ka thënë se respektimi i masave për pengimin e përhapjes së virusit dhe luftimin e tij nuk është në nivelin e duhur, pasi rastet pozitive dhe rastet e vdekjeve po shtohen

II. DICK MARTY DHE PROPAGANDA SERBE



Shkruan: Bardyl
MAHMUTI

KUSH I PAGUAN AVOKATËT PRANË GJYKATËS NË HAGË?



RENOVA
PUTZ
Makedoni Xheqisht-Tetovë Curë-Ferizaj Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200 Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.
DEGA KOSOVE
Rrugë "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

SHTËPIA E VERDHË - VMA

F. 11

Shkruan:
Ragip SHALA



AKTUALE



MONIKA KRYEMADHI
RIZGJEDHET KRYETARE E LSI-së

F. 2

KOSOVA HESHT, OKB I SUGJERON DËMSHPËRBLIM PËR GJASHTË SHTETASIT E DËBUAR TURQ F. 6

EKONOMI



NEVOJA E NDËRTIMIT TË AUTOSTRADËS NË KOHË PANDEMIE F. 9

KOMUNAT DUHET TË JENË MË PËRKRAHËSE NË ZHVILLIMIN E EKOSISTEMIT TË NDËRMARRËSISH F. 8

SPORT

NUK GABOJNË FAVORITËT F. 14

Veliaj i bashkohet nismës 'Liria ka emër, UÇK'

PRISHTINË, 22 NËNTOR- "Liria ka emër, UÇK" është një ndër nismat që është kthyer në virale në rrjetet sociale në mbështetje të ishpërfaqësuesve të UÇK-së që janë thirrur në Hagë. Kësaj nisme i është bashkuar edhe kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj i cili ka pritur në zyrën e tij, bashkë me Pandeli Majkon, disa prej organizatorëve të saj, deputeten Eliza Hoxha dhe regisoren Burbuqe Berisha.

Veliaj ka theksuar se gjyktimi i udhëheqësve të UÇK-së është rast i paprecedent, dhe një proces nga i cili do të dalin ballëlartë të gjithë ata që bënë realitet përpjekjet për liri. Liria ka emër, e ky emër është gravurë në gjakun e mijëra të rënëve për liri e të gjallëve që e çuan në vend amanetin", ka shkruar Veliaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Evropa po shqyrton mundësinë e lehtësimit të masave para Krishtlindjes

PARIS, 22 NËNTOR- Disa javë në përballje me valën e dytë të koronavirusit, disa vende në Evropë po shqyrtojnë mundësinë e lehtësimit të masave kufizuese, pas disa sinjalave se masat e ndërmarrë kanë frenuar përhapjen e pandemisë.

Lehtësimi i mundshëm i masave kufizuese vjen pothuajse një muaj para Krishtlindjes, teksha ka shqetësime për ndikimin social dhe ekonomik të masave kufizuese. Presidenti i Francës, Emmanuel Macron do të mbajë një fjalim lidhur me situatën me



pandeminë dhe mund të njoftojë për heqjen e pjesshme të masës së mylljës kombëtare, që është në fuqi që prej 30 tetorit. Në Gjermani është duke u diskutuar nëse duhet që vendimi

për myllje të pjesshme që pritet të skadojë më vonë gjatë këtij muaji, të vazhdohet apo jo. Në Poloni, kryeministri Mateusz Morawiecki ka paralajmëruar qytetarët kundër çdo udhëtimi gjatë kohës së Krishtlindjes, por tha se dyqanet do të lejohen të riapen plotësisht nga 28 nëntori. Teatrot, baret dhe restorantet do të jenë të myllura deri pas Krishtlindjeve dhe në shkolla do të vazhdojë mësimi nga distanca.

Italia po ashtu po përpinqet të shpëtojë krishtlindjen e parë në erën e koronavirusit. Më 3

dhjetor atje skadojnë masat aktuale dhe po punohet për përcaktimin e rregullave në periudhën e festave. Zyrtarët thonë se dy javët e ardhshme do të jenë thelbësore. Ata flasin përrregulla mbi lëvizjet mes rajoneve, por nuk do të ketë lëshime për evenete në sheshe, e as përfesta, mbi të gjitha në natën e ndërrimit të viteve. Vetë kryeministri Conte ka pohuar pak ditë më parë se duhet të përgatitemi për Krishtlindje më ndryshtë, me festimet, puthjet dhe përqafimet që nuk do të jenë të mundura.

Monika Kryemadhi rizgjedhet kryetare e LSI-së

TIRANË, 22 NËNTOR- Monika Kryemadhi është zgjedhur edhe për një mandat në postin e kryetares së Lëvizjes Socialiste për Integrism (LSI). Kryemadhi pa asnjë kundërkandidat ka marrë gjithsej 42 mijë e 807 vota, nga 44 mijë e 413 sa kanë votuar. Lajmin e ka barë me dije kryetarja e Komisionit Qendror Zgjedhor të LSI-së, Silvana Caka, në një konferencë për medie. "Ju bëjmë me dije, se për shkak të ndalimit të qarkullimit prej 22:00-06:00 materialet

zgjedhore për disa qendra votimi jashtë qarkut të Tiranës janë dorëzuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve gjatë parades së sotme. Bazuar në tabelat përbledhëse të rezultateve, konfirmojmë se ka përfunduar procesi i numërimit të fletëve të votimit për kryetarin e Lëvizjes Socialiste për Integrism. Nga rezultatet e administruara kanë votuar 44 413 anëtarë nga të cilët 42 807 votuan pro kandidatit për kryetar të Lëvizjes Socialiste për Integrism.

zonjën Monika Kryemadhi. Bazuar në rezultatet e mësipërme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpall kryetare të Lëvizjes Socialiste për Integrism, Monika Kryemadhin", ka thënë Caka.

Ajo ka bërë me dije se është duke vazhduar procesi i numrit të votave për delegatët e Konventës Kombëtare, ndërsa ka inkurajuar grupet e numërimit për të nxjerrë sa më shpejt rezultatin për ekipin fitues të Lëvizjes Socialiste për Integrism.



Pas Greqisë, edhe Mali i Zi mbyll kufirin me Shqipërinë

PODGORICË, 22 NËNTOR- Autoritetet e Policisë Malazeze, në bazë të një njoftimi zyrtar që i kanë dërguar Pikës së Kalimit Kufitar Bozhaj/Hani i Hotit,

kanë sqaruar se në kuadër të kufizimeve të reja për shkak të pandemisë Covid-19, deri më 23 nëntor do të lejohen të hyjnë në Malin e Zi, vetëm personat me leje qëndrimi, me

leje pune, ata të cilët kalojnë transit në territorin malazez dhe ata që udhëtojnë drejt Aeroportit të Podgoricës (të cilët duhet të jenë të pajisur me prenotimet e biletave).

Policia Kufitare Shkodër, iu bën thirrje të gjithë qytetarëve të cilët nuk bëjnë përjashtim nga këto kufizime, të shmangin udhëtimin në drejtim të këtyre pikave të Kalimit Kufitar.





Shkruan: Bardhyll MAHMUTI

II. Dick Marty dhe propaganda serbe

Shpallja e pafajësisë së plotë të komandantëve të UÇK-së nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavi dhe hedhja poshtë e shpifjeve serbe për gjoja "trafikimin e organeve njerëzore nga UÇK-ja" pati ndikim edhe te sajuesit e dosjeve kundër UÇK-së. Sipas pohimeve të Vlladimir Bozhoviqit, "dokumentacioni i plotë i këtyre dosjeve mbeti në godinën e qeverisë federale dhe atë e morën Sanda Rashkoviq-Iviq dhe njerëzit e saj. Sipas njohurive që kam, më vonë një pjesë e dokumentacionit u shkatërrua, ndërsa një pjesë ngeli aty dhe përfatim e saj nuk di asgjë. Por, e di se pas kësaj kohe asgjë nuk është punuar, vdiq çdo aktivitet" [Politika, Zatrgovinuorganima Beograd saznao pre devet godina (Për tregtinë me organe Beograd ka qenë në dijeni para nëntë vjetësh), 01.01.2011].

Të asgjësosh një pjesë të dokumenteve për "krimet më të neveritishme" që pretendohen se u ishin bërë serbëve në kampet e Shqipërisë dhe të bësh që edhe në Beograd "të vdesë" aktiviteti për ndriçimin e këtyre krimave të rënda, është dëshmi se edhe trilluesit e kësaj gjënjeshtrë ishin të bindur se askush nuk u besonte "përrallave dhe legjendave" të tyre! Mirëpo, përvëç Carla Del Pontes dhe John Clint Williamsonit, Dick Marty, një ish-prokuror tjetër zviceran që ishte "konvertuar" në politikan, u shqua në shpërndarjen e sajave të Shërbimit Sekret të Serbisë. Gjatë tërë periudhës së zbatimit të genocidit kundër shqiptarëve në Kosovë, ky ish-prokuror që përfqaqësonë Partinë Liberale-Radikale zvicerane në Asambleën

Federale, asnjëherë nuk e kishte ngritur zërin për ta kërkuar ndërprerjen e fushatës ushtarake dhe poliore serbe në Kosovë, megjithëse botërisht dihej se gjatë asaj fushate u vrante mijëra civilë shqiptarë dhe qindra mijëra të tjera u dëbuat me qëllim të spastrimit etnik të Kosovës. Mirëpo, ndërhyrja e Aleancës Veriatlantike për ta ndërprerë barbarinë e Serbisë ndaj shqiptarëve, mobilizoi Dick Martyn të dilte në ballë të mobilizimeve që kërkonin ndërprerjen e bombardimeve kundër caqeve të ushtrisë dhe policisë serbe! Dick Marty, së bashku me 19 edëputet të parlamentit zviceran, i rekomanduan Këshillit Federal të Zvicrës "masat që synonin t'i jepnin fund luftës në Kosovë". Në këto rekomandime kërkohet nga institucioni më i lartë qeverisës i vendit të tyre që të bëjë çdo gjë që ishte e mundur për të ardhur deri te një "armëpushim mes palëve, të vendoset një trupë neutrale për të ruajtur paqen dhe të përgatitej terreni për zgjidhje politike", Dick Marty as që përmend OKB-në. Sipas kësaj logjike, anashkalimi i Këshillit të Sigurimit të OKB-së për të ndërprerë bombardimet kundër regjimit të Millosheviqit nuk ishte ilegal!

Të kërkosh më 21 prill 1999 vendosjen e një "trupë neutrale për të mbikëqyrur armëpushim mes palëve dhe për të ruajtur paqen" dhe të luash rolin e injorantit që gjoja nuk e di se një armëpushim ndërmjet "palëve ndërluftuese" ishte arritur më 13 tetor 1998 dhe se përmendështje e këtij armëpushimi u caktua Misioni Verifikues i OSBE-së me pjesëtarë të paarmatosur, nuk është asgjë tjetër pos përpjekje për të fshehur të vërtetën se ky mision dështoi për shkak të politikës së gjenocidit që kishte përpiluar shteti serb.

Të kërkosh më 21 prill 1999 që "të ndërpiten bombardimet kundër Serbisë" dhe të vendoset një "trupë neutrale" në të cilën nuk do të ketë pjesëtarë të shteteve të përfshira në këto bombardime,

"zgjidhje politike" (Réseau Voltaire, Dick Marty: "L'indépendance du Kosovo a été décidée à Pristina", entretien avec Silvia Cattori (Dick Marty: Pavarësia e Kosovës nuk u vendos në Prishtinë, interview avec Silvia Cattori).

Për të denoncuar "agresionin illegal kundër Serbisë, pa miratimin e OKB-së", Dick Marty ishte tepër i zhëshëm! Por, kur ai i rekomandon Këshillit Federal të Zvicrës që të bëjë çdo gjë që ishte e mundur për të ardhur deri te një "armëpushim në mes palëve, të vendoset një trupë neutrale për të ruajtur paqen dhe të përgatitej terreni për zgjidhje politike", Dick Marty as që përmend OKB-në. Sipas kësaj logjike, anashkalimi i Këshillit të Sigurimit të OKB-së për të ndërprerë bombardimet kundër regjimit të Millosheviqit nuk ishte ilegal!

dhe të luash rolin e injorantit që gjoja nuk e di se shumica e shteteve të demokratike përendimore ishin të angazhuara në operacionet e NATO-s, nuk është asgjë tjetër pos mbështetje e hapur e kërkave të Sllobodan Milosheviqit që kjo "trupë neutrale" të përbëhej nga pjesëtarë të forcave ruse, bjelloruse, kinezë, indiane apo të ndonjë vendi tjetër që dënonë sulmet e NATO-s.

Të kërkosh më 21 prill 1999 që "të përgatitet terreni për një zgjidhje politike" të Çështjes së Kosovës

dhe të luash rolin e injorantit që gjoja nuk e di që Serbia nuk nënshkroi Projekt-Marrëveshjen e propozuar në Konferencën Ndërkombëtare të Rambujesë për shkak të planeve gjenocidare, nuk është asgjë tjetër pos mishërim i plotë me propagandën e regjimit të Milosheviqit.

Luftha përfundoi ashtu siç e dinë të gjitha ata që kanë qenë të interesuar për këtë çështje. Edhe forcat ndërkombëtare civile dhe ushtarake u vendosën në Kosovë për të siguruar paqen dhe për të përgatitur parakushtet përfundim. Lufta përfundoi edhe 120 ditë të tjera dhe, më në fund, në përputhje të plotë me konkluzionet e raportit të Martti Ahtisaari, më 17 shkurt 2008 Kuvendi i Kosovës shpalli Kosovën shtet të pavarur.

Pas dështimeve diplomatike për ta penguar shpalljen e pavarësisë së Kosovës, diplomacia serbe u mobilizua për ta paraqitur këtë shpallje si të ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.

Nga të gjithë intelektualët e profesionaleve të ndryshme, që kishin për emrues të përbashkët antiamerikanizmin si këndvështrim ideologjik që u rreshqant përkrah interpretimit serb të së drejtës ndërkombëtare, në vazhdim do t'i përmend vetëm Carla Del Ponten dhe Dick Martin. (VJON)



SPITALET DHE KLINIKAT NË KOSOVË JANË MBUSHUR ME PACIENTË TË INFETUAR ME COVID-19


RENDOHET GJENDJA ME COVID NË KOSOVË, NUK RESPEKTOHEN MASAT

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar të dielën se në 24 orët e fundit, dhjetë pacientë kanë vdekur nga Covid-19 dhe janë regjistruar edhe 707 raste të reja me Covid. Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, së bashku me ushtruesin e detyrës së drejtorit të ShSKUK-së, dr. Saudin Maliqi, gjatë fundjavës ka vizituat klinikat e QKUK-së për ta parë gjendjen sa iu përket hapësirave dhe situatës me barna për trajtim të pacientëve me Covid-19. Zemaj ka theksuar se spitalet dhe klinikat janë të mbushura me pacientë të infektuar me Covid. Ai ka thënë se respektimi i masave për pengimin e përhapjes së virusit dhe luftimin e tij nuk është në nivelin e duhur, pasi rastet pozitive dëshmojnë rastet e vdekjeve po shtohen.

Armend Zemaj, së bashku me ushtruesin e detyrës së drejtorit të ShSKUK-së, dr. Saudin Maliqi, gjatë fundjavës ka vizituat klinikat e QKUK-së për ta parë gjendjen sa iu përket hapësirave dhe situatës me barna për trajtim të pacientëve me Covid-19. Zemaj ka shtuar se klinikat dhe spitalet janë të mbushura. "Personeli shëndetësor, në çdo klinikë dhe spital, përkundër lodhjes dhe ngarkesave, janë në krye të

detyrës. Kërkova që pacientët ta kenë trajtimin e duhur, të mos ketë mungesa, as të hapësirave, as barnat e Listës Esenciale dhe atyre të protokolleve, oksigjeni dhe çdo gjë tjeter për trajtimin efikas të pacientëve", ka thënë Zemaj. Ai ka shtuar se klinikat dhe spitalet janë të mbushura. "Personeli shëndetësor është tejet i angazhuar, por jeta e qytetarëve tanë është më e

vlefshme se çdo gjë tjeter", është shprehur ai. Ministri Zemaj ka bërë thirrje për respektim të masave anti-Covid. "Respektimi i masave për pengimin e përhapjes së virusit dhe luftimin e tij nuk është në nivelin e duhur sepse rastet pozitive dëshmojnë rastet e vdekjeve po shtohen. Mos i jepni rast virusit. Ndryshoni sjelljen tuaj. Numri i madh i



personave me virusin Covid-19 dhe numri i madh i rasteve të vdekjeve do shërbyer si sinjal i fuqishëm për pakujdesinë në shtetin tonë”, ka thënë ai.

Zemaj ka thënë se derisa ende nuk janë në përdorim vaksinat kundër virusit, mënyra e vetme për t'u mbrojtur, është distanca, maska dhe higjiena. “Zbatoni masat kundër virusit vdekjeprurës, ndryshe numrat nuk do të ulën. Ndryshoni sjelljen tuaj për ta ndryshuar gjendjen në Republikën tonë, ndryshe na presin sfidat edhe më të mëdha!”, ka thënë ministri Zemaj.

Edhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës përmes një reagimi ka bërë thirre që të respektohen masat anti-Covid. “Mbani maska, mbronit të afërmit tuaj! Maskat janë të obliguara kudo! Mbani distancën! Virusi është gjithandje! Mos lejoni të rezikonit kaq shumë jetë! Ruani personat me sëmundje kronike dhe të moshuarit! Ruani veten dhe të afërmit tuaj! Na ruami neve punëtorëve shëndetësorë që t'ju ruajmë shëndetin tuaj!”, është bërë me dije në reagimin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës.

Javën e kaluar deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë debatuar në një seancë plenare lidhur me menaxhimin e situatës me pandeminë Covid-19. Deputetët e opozitës kanë theksuar se situata me pandemi është përkqësuar. Sipas tyre, numri i madh i rasteve të të prekurve me virus dhe vdekjeve është alarmant.

Ministria e Shëndetësisë ka data 20 nëntor 2020, ka njoftuar përmes e reja që do të jenë në fuqi përmes komunat e Kosovës, sipas kategorizimit të ri lidhur me numrin e të infektuarve në 100 000 banorë.

Në zonën e kuqe bëjnë pjesë komunat me rrezik të lartë apo komunat me mbi 151 të infektuar në 100.000 banorë brenda javës. Në këtë zonë janë

18 komuna: Prishtina, Fushë-Kosova, Gjilani, Obiliqi, Gjakova, Shtimja, Podujeva, Peja, Ferizaj, Mitrovica e Jugut, Vushtrria, Lipjani, Vitia, Zveçani, Leposaviqi, Zubin Potoku, Mitrovica e Veriut dhe Kamenica.

Në zonën e verdhë bëjnë pjesë komunat me rrezik të mesëm, apo komunat prej 76 deri në 150 të infektuar në 100.000 banorë brenda javës. Në këtë zona janë 14 komuna: Prizreni, Klina, Deçani, Drenasi, Malishevë, Suhareka, Novobërdë, Graçanica, Ranillugu, Parteshi, Kaçaniku, Kllokoti, Rahoveci dhe Skenderaj.

Në zonën e gjelbër bëjnë pjesë komunat me rrezik të ulët apo komunat prej 1 deri në 75 të infektuar në 100.000 banorë brenda javës. Në këtë zonë bëjnë pjesë 6 komuna: Mamusha, Dragashi, Shtërpca, Juniku, Istogu dhe Hani i Elezit.

Policia, e mobilizuar për zbatimin e masave anti-Covid

Policia e Kosovës, gjatë zbatimit të masave të ndërmarrë nga institucionet e vendit, si pasojë e pandemisë Covid-19, përmjet e katër orët e fundit, kanë shqiptuar dënimë përmes respektimit të këtyre masave.

Në raste të veçanta Policia e Kosovës po ashtu ka asistuar inspektorët sanitare komunalë, në kontroll të lokaleve hoteliere të cilat janë takuar duke mos i përbushur masat anti-Covid. “Policia e Kosovës i thirret qytetarët që t'i respektojnë me përpikëri masat e ndërmarrë nga ana e institucioneve të vendit që kanë vetëm një qëllim: mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve tanë, në të kundërtën policia do të jetë e detyruar të veprojë komfor Ligjet anti-Covid dhe t'i ndëshkojë të gjithë ata që bien ndesh me këtë ligj”, është theksuar në njoftimin e Policisë së Kosovës.



PDK-ja thotë se qeveria dështoi ta menaxhojë pandeminë në shkolla dhe mësimin online

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Sejdi Hoxha, ka thënë se Qeveria e Kosovës ka dështuar ta menaxhojë pandeminë në shkollat e Kosovës duke mos ofruar masa mbrojtëse ndaj Covid-19 ku, si pasojë, shumë shkolla u mbyllën e shumë nxënës e mësimdhënës u infektuan me virus. Ai tha se shumë shkolla në mbarë vendin u lanë nga qeveria pa dezinfektues dhe nuk u bë dezinfektimi i hapësirave shkollore. Deputeti Hoxha, po

ashtu, theksoi faktin se qeveria aktuale e Avdullah Hotit, njësoj si qeveria e Albin Kurtit, po dështon ofrimin e mësimit online, ku nxënësit kosovarë po humbin komplet një vit shkollor duke shikuar vetëm ligjëratë të përsëritura në televizion. Ai tha se, përvëç dështimit të plotë në organizimin e mësimit në pandemi, qeveria aktuale po i politizon tërësish bordet e universiteteve dhe për këtë paralajmëroi thirjen e ministrit të Arsimit në përgjegjësi parlamentare. “PDK-ja është shumë e shqetësuar me papërgjegjësinë e kësaj qeverie rreth mosbatimit të masave mbrojtëse kundër Covid-19 në institucionet

edukative-arsimore. Sot shkollat në Kosovë nuk janë të furnizuara me dezinfektues, nuk bëhet dezinfektim i rregullt i hapësirave publike në shkolla, nuk dërgohen fare ekipe mjekësore të cilat duhet të përkujdesen për shëndetin e nxënësve, mësimdhënësve, stafit teknik dhe administrativ. Si rezultat i këtij moskujdesi virusi po përhapet me shpejtësi të madhe në shumë shkolla anekënd Kosovës. Qeveria e Kosovës, edhe pse bëri rishikimin e buxhetit në kohë pandemie, nuk parashikoi mjete financiare shtesë me të cilat do të mund ta rrissë nivelin e respektimit të masave mbrojtëse në shkolla”, ka thënë ai.

Mustafa e lë të hapur mundësinë që të bëhet president pas zgjedhjeve të reja

PRISHTINE, 22 NËNTOR- Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa është duke e lënë të hapur të marrë edhe pozitën më të lartë shtetërore, atë të presidentit të Kosovës, por vetëm pas zgjedhjeve të reja. Gjatë ditëve të ardhshme, ai ka paralajmëruar tryezë për të diskutuar përmes emrin e mundshëm të shefit të shtetit.

Nëse nuk merren vesh përmes president, Mustafa ka paralajmëruar marrëveshje përmes zgjedhjeve. “Në këtë mandat, LDK-ja e ka kryeministrin e vendit. Nuk pretendojmë edhe pozitën e presidentit. Nëse shkojmë në zgjedhje, çdo

opsion mbetet i hapur”, ka thënë Mustafa. Lideri i partisë më të madhe në qeveri ka thënë se zgjedhjet nuk duhet të mbahen, por nëse dështon pajtimi përmes një emër të presidentit atëherë zgjedhjet janë të pashmangshme. “E vlerësojmë se zgjedhjet në këtë situatë pandemie nuk do duhej të mbahen. Por, në qoftë se nuk pajtohem përmes presidentin, do të pajtohem përmes zgjedhjeve”, ka thënë Mustafa përmes “Telegrafit”. Aktualisht, Kosova s’ka president ndërsa në zyrën e shefit të shtetit ndodhet kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani.



Kosova hesht, OKB i sugjeron dëmshpërblim për gjashtë shtetasit e dëbuar turq



PRISHTINË, 22 NËNTOR- Gjashtë shtetasit turq Kahraman Demirez, Mustafa Erdem, Hasan Huseyin Gunakan, Yusuf Karabina, Osman Karakaya dhe Cihan Ozkan të arrestuar në Kosovë dhe të dëbuar në Turqi në mars 2018, u dënuan me 56 vjet dhe 7 muaj e gjysmë burgim. Por, përkundër shumë raporteve vendore e ndërkombëtare, institucionet e drejtësisë në Kosovë deri më tani nuk kanë ngritur asnjë aktakuzë ndaj personave që dyshohen se kanë shkelur ligjin gjatë arrestimit dhe dëbimit të tyre. Për këtë rast, shkelje të ligjeve të Kosovës, Kushtetutës dhe konventave ndërkombëtare ka konstatuar së fundmi edhe Këshilli për të Drejtat e Njeriut i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Në një raport të publikuar nga Grupi i Punës për Ndalimin Arbitrar, që është një organ i përbërë nga ekspertë të pavarur për të drejtat e njeriut që hetojnë rastet e arrestimit dhe ndalimit arbitrar,

kritikohen institucionet e Kosovës për veprimet e paligjshme në rastin e dëbimit të gjashtë shtetasve turq. Në reportin e publikuar nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut dëshmohet se si institucionet e Kosovës nuk i janë përgjigjur grupit punues të OKB-së që ka kryer hetim për këtë rast. Ky grup, në muajin dhjetor të vitit të kaluar përmes misionit të OKB-së në Kosovë, UNMIK-i ka dërguar kërkesë zyrtare institacioneve të Kosovës duke kërkuar që të sqaroherë veprimet e ndërmarra në rastin e arrestimit dhe dëbimit të gjashtë shtetasve turq. “Grupit Punues i vije keq që nuk ka pranuar përgjigje nga Kosova”, thuhet në raport. Grupi Punues konstaton shkelje të shumta duke përfshirë ato që janë bërë nga Agjencia e Kosovës përi Inteligjencë, Policia e Kosovës si dhe institucionet të tjera të përfshira në aksionin e 29 marsit, 2018. Në raport më tej thuhet se ka dyshime të shumta se akuzat

ndaj gjashtë shtetasve turq, janë të pabazuara. Grupi Punues kërkon lirimin e të dënuarve si dhe kërkon nga institucionet e Kosovës “që të garantojnë kompensim dhe dëmshpërblime të tjera në përputhje me ligjin ndërkombetar”. Më 4 korrik të vitit të 2019, Prokuroria Speciale e Kosovës i tha “Radios Evropa e Lirë” se “janë marrë në pyetje dëshmitarë si dhe një numër mjaft i madh i të dyshuarve”. Por, hetimet që filluan në vitin 2018 nuk është se kanë prodhuar ndonjë rezultat. Që nga kjo kohë, Prokuroria Speciale e Kosovës nuk ka dhënë ndonjë informacion për hetimet apo ngritjen eventuale aktakuzave. Të pyetur disa herë nga “Radio Evropa e Lirë” se në çfarë faze janë hetimet, Prokuroria Speciale e Kosovës nuk ka kthyer përgjigje. “REL” ka provuar sërisht që të marrë informacione nëse hetimet kanë përfunduar me ngritjen e ndonjë aktakuze,

por zyrtarët e Prokurorisë nuk janë përgjigjur. Juristi Kushtrim Palushi thotë se është e pakuptimtë heshtja e organeve të drejtësise në këtë rast.

Kuvendi i Kosovës kishte krijuar një komision hetues që konstatoi më shumë se 30 shkelje me rastin e dëbimit. Pavarësisht se raporti i këtij komisioni i është dorëzuar edhe Prokurorisë së Kosovës, ish-anëtari i këtij komisioni, Sami Kurteshi, nuk beson se në Kosovë ka hetues apo prokuror që guxon t'i hetojë personat që kanë qenë të përfshirë drejtpërsëdrejti në këtë rast. Përveç organizatave joqeveritare, edhe Avokati i Popullit në Kosovë, kishte konstatuar dhjetëra shkelje në operacionin e arrestimit dhe dëbimit.

Ky institucion kishte kërkuar hetime penale për personat përgjegjës. Për këtë rast, Inspektorati Policor i Kosovës kishte parashtruar kallëzim penal ndaj 22 zyrtarëve të Policisë së

Osmani shkarkon Rikallon nga KOZ-ja

PRISHTINË, 22 NËNTOR-
Ushtruesja e detyrës së presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani ia ka ndërprerë mandatin në Komisionin Qendror Zgjedhor (KQZ), përfaqësuesit të Listës Serbe, Nenad Rikallo. Sipas njoftimit të Zyrës së Presidencës, shkarkimi i Rikallos është bërë

pasi ia ditë më parë ka marrë një pozitë të lartë në të ashtuquajturën Zyre për Kosovën në Qeverinë e Serbisë. "Nenad Rikallos i ndërpritet mandati si anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit",

thuhet në vendimin e u.d. të presidentit, Vjosa Osmani. Sipas njoftimit, këtë vendim Osmani e ka marrë bazuar në nenin 90 të Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjit përzgjedhjet e përgjithshme të Kosovës.

Më 6 shkurt, 2020, Nenad Rikallo, së bashku me nëntë

përfaqësues të tjera të partive politike, ishte emëruar në KQZ si përfaqësues i Listës Serbe. Rikallo më herët ka mbajtur postin e ministrit të Bujqësisë së Kosovës, në kohën kur qeverinë e udhëhiqte Ramush Haradinaj, por ishte shkarkuar nga ky post më 2 shkurt të vitit 2019.



Kush i paguan avokatët pranë Gjykatës në Hagë?

PRISHTINË, 22 NËNTOR- Ish-udhëheqësit kryesorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët po përballen me aktakuza për krimet lufte në Dhomat e Specializuarë nga Hagë, mund të mbesin pa mbulesë të plotë financiare nga shteti për mbrojtjen e tyre. Ata kanë angazhuar avokatë të njohur ndërkombëtarë, e që kostoja e tyre, mund të tejkalojë tarifat e përcaktuara nga Ministria e Drejtësisë e Kosovës. Bashkë me miratimin e Ligjit për Dhomat e Specializuarë në gusht të vitit 2015, Kuvendi i Kosovës po ashtu kishte miratuar një ligji, sipas të cilit, çdo i akuzuar potencial nga Dhomat e Specializuarë ka të drejtën për ndihmë financiare dhe mbulim të shpenzimeve të mbrojtjes. "Të gjithë personat e akuzuar kanë të drejtë e kërkesës për asistencë në mbulimin e shpenzimeve të mbrojtjes dhe të angazhimit të mbrojtësit të pavarur, me përvojë dhe kompetencë, që paguhën nga buxheti i Kosovës, i alokuara për qëllimet e këtij ligji", thuhet mes tjerash në këtë ligji.

Por, me udhëzimin administrativ MD - Nr. 02/2020, të datës 24 korrik 2020, të nënshkruar nga ministri i Drejtësisë Selim Selimi, përcaktohet se mbulimi financiar i avokatëve, bëhet në bazë të tarifave të përcaktuara nga Oda e Avokatëve të Kosovës; tarifave për avokatë në Holandë; tarifave të shtetit prej nga vjen mbrojtësi dhe tarifave për mbrojtje juridike të personit të akuzuar potencial të Dhomave të Specializuarë.

Drejtori ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), Ehat Miftaraj, thotë se rregullativa ligjore është e qartë. Sipas tij, ata që në Hagë kanë avokatë të famshëm ndërkombëtarë, do të duhet të paguajnë vetë një pjesë buxhetit. "Mbrojtja e avokatëve ndërkombëtarë mund të jetë shumë, shumë e shtrenjtë, por kjo nuk do të thotë që të njëjtë (të akuzuarit) mund të marrin avokatët më të shtrenjtë për t'i përfaqësuar ata. Këtë mund ta

bëjnë, por përmes buxhetit të tyre", tha Miftaraj për "Radion Evropa e Lirë".

Sa kushton mbrojtja?

Shumat që kerkohen nga avokatët mbeten konfidenciale, por bazuar në përvojat e mëhershme, bëhet fjalë për miliona euro. Micheal O'Reilly ka qenë pjesë e ekipit mbrojtës të ish-kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj gjatë proceseve gjyqësore në Tribunalin e Hagës për Krimet në ish-Jugosllavi. Në një shkrim për Irishtimes, O'Reilly, më 23 maj 2015, kishte shkruar se Haradinaj ka paguar 11 milionë euro për mbrojtjen e tij. "I thash atij se do t'i kushto 5 milionë euro për të pasur mbrojtjen që i duhet. Në fakt, i kushtoi 11 milionë euro dhe të gjitha ishin donacion nga populli i Kosovës. I thash atij se ky gjykim do t'a merrte dy vjet të jetës së tij (edhe jetës time) në fakt, ia mori tetë, katër nga të cilat i kaloi në burg", kishte shkruar O'Reilly.

Tashmë, ish-krerët më të lartë të UÇK-së kanë publikuar ekipet e tyre mbrojtëse, e që përbëhen nga emra prominent.

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi do të mbrohet nga Pierre-Richard Prosper, David Hooper dhe Dastid Pallaska.

Ish-kreu i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli ka zgjedhur për avokat britanikun Ben Emmerson, i cili e ka mbrojtur në Tribunalin e Hagës edhe ish-kryeministrin Ramush Haradinaj. Në ekipin mbrojtës të Veselit është edhe britaniku tjetër, Andrew Cayley.

Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi ka angazhuar avokaten nga Malajzia, Venkateswari Alagendra.

Ndërkq, deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje Rexhep Selimi, ka zgjedhur si përfaqësues ligor në mbrojtjen e tij kundër avokatët më të shtrenjtë për t'i përfaqësuar ata. Këtë mund ta

Young. Avokat më pak të njohur ndërkombëtarët ka ish-pjesëtarët tjetër i UÇK-së, Salih Mustafa që është i akuzuar për krimet lufte. Mustafën do ta mbrojë holandezi, Julius Von Bone.

Transparencë për shpenzimet e mbrojtjes

"Radio Evropa e Lirë" ka kerkuar sqarime nga Ministria e Drejtësisë lidhur me atë se si do të veprohet me rastet kur të akuzuarit do të kërkojnë mbulesë financiare më të madhe se sa parashikohet në tarifat e përcaktuara, por nuk ka marrë asnjë përgjigje. Në bazë të udhëzimit administrativ, ministria do të krijojë një komision, i emëruar nga ministri i Drejtësisë, që do të udhëhiqet nga sekretari i përgjithshëm i ministrisë, e që do të ketë në përgjegjësi miratimin ose refuzimin e kërkesave për financim të mbrojtjes ligjore.

Në Institutin e Kosovës për Drejtësi, kërkojnë që Ministria e Drejtësisë të jetë transparente në pagesat që do t'i kryejë për avokatët mbrojtës. "Transpareanca dhe llogaridhënia janë bazike për të siguruar se të gjithë personat e akuzuar mund të marrin mbrojtjen financiare, në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe jo siç ka ndodh deri më tash, kur kjo është bërë në baza selektive", tha Ehat Miftaraj nga IKD. "Në këtë drejtim, Qeveria e Kosovës duhet të ndryshojë menjëherë taktilën e deritanishme, në mënyrë që çdo lloj i ndihmës financiare të jetë publike dhe kërkesat për ndihmë financiare të janë po ashtu publike. Kjo do të shmanget mundësinë që persona të caktuar të janë të privilegjuar e disa të tjerë jo, siç ka ndodhur deri më tanë", shtoi ai. Por, transpareanca që po kerkohet nga kjo organizatë, është vënë në pikëpyetje, pasi më 16 nëntor, Ministria e Drejtësisë, ka bërë



amendamentimin e udhëzimit administrativ të datës 24 korrik, 2020, e ku ka publikuar formën e kontratës që do të nënshkruajë me avokatët mbrojtës.

Aty përcaktohet se marrëveshjet do të mbesin konfidenciale. "Ministria pranon që kjo marrëveshje si dhe çdo komunikim në të ardhmen në mes të avokatëve dhe klientit ose në mes të avokatëve dhe ministrisë, janë rreptësish konfidenciale".

Si bëhet kërkesa për financimin e mbrojtjes juridike?

Të gjithë të akuzuarit ose të autorizuarit e tyre duhet të plotësojnë një kërkesë zyrtare për mbulimin e shpenzimeve të mbrojtjes juridike. Në këto shpenzime mund të përfshihen të gjitha shërbimet që i kryen ekipi mbrojtës, duke përfshirë madje, edhe shpenzimet e zyrës dhe telefonatave, gjë e cila nuk ishte parashikuar në udhëzimin e parë administrativ, e që u lejua në udhëzimin e fundit, të datës 16 nëntor. E njëjtë lëndë më tej procedohet nga komisioni i caktuar për këtë çështje.

Por, pos mbulimeve të shpenzimeve të përfaqësimit ligor, shteti do të paguajë edhe për të gjitha shpenzimet e

vizitave të familjarëve të personave të akuzuar nga Dhomat e Specializuarë. Kjo është e rregulluar me një udhëzim të veçantë administrativ, të datës 23 korrik 2020. "Çdo person i akuzuar potencial, brenda një viti, ka të drejtë të vizitohet me mbështetje të nevojshme financiare, më së shumti nga dymbëdhjetë anëtarë të ngushtë të familjes, dhe jo më shumë se tre anëtarë të familjes për një vizitë", përcaktohet në udhëzim. Në këtë kategori përfshihen bashkëshortët, fëmijët, prindërit, vëllezërët dhe motrat. Në kuadër të Ligjit për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencialë në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuarë, eshtë përfshirë edhe realizimi i së drejtës për kompensimin e personave të akuzuar për krimet e pretenduara në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuarë, të shpallur të pafajshëm me vendim të plotfuqishëm. Deri më tash, për proceset e para në Hagë, janë ndarë 61 mijë euro nga Qeveria e Kosovës. Ndërkq për vitin e ardhshëm, në projektbuxhet janë parashikuar 6,7 milionë euro për mbulimin e shpenzimeve të mbrojtjes të të akuzuarve nga Dhomat e Specializuarë.

Ministria e Jashtme refuzon kërkesën e Vuçiqit që ta vizitojë Kosovën

PRISHTINË, 22 NËNTOR (ER)- Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Qeverinë e Kosovës, Meliza Haradinaj-Stublla ka bërë me dije se ka refuzuar kërkesën për vizitë në Kosovë të presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, dhe dy zyrtarëve të tjerë serbë. Ministrja Haradinaj-Stublla ka thënë se kërkesa e presidentit Vuçiq, ministrit të Mbrojtjes, Aleksandar Vulin dhe shefit të Zyrës për Kosovën në Qeverinë serbe Petar Petkoviq për të



tjetër". "Qytetarët e Kosovës, familjet e të pagjeturve, të vranëve dhe të masakruarve nga forcat pollore, ushtarake dhe paramilitare serbe, pyesin me të drejtë se çka do të ndodhë pas zbulimit të varrezave masive dhe rivarrosjeve? Deri kur drejtësia ndërkombëtare do të lejoj, që po ata që kryen krimet te kryejnë edhe hetimet e gjykimet?", ka thënë Haradinaj-Stublla, ka njoftuar MPJD përmes një komunikate për media.

Nevoja e ndërtimit të autostradës në kohë pandemie



PRISHTINË, 22 NËNTOR- Autostrada që lidh qytetet Istog - Pejë - Deçan - Gjakovë dhe Prizren, apo siç njihet ndryshe "Autostrada e Dukagjinit" është paraqitur në Projektitligjin e buxhetit për vitin 2021. Ky projekt po konsiderohet i panevojshëm, në kohën kur Kosova po ballafaqohet me krisë ekonomike për shkak të pandemisë së shkaktuar nga koronavirusi, thotë Skënder Krasniqi, drejtor në Odën e Afarizmit të Kosovës. Për këtë autostradë, në Projektbuxhetin e viti të ardhshëm janë paraparë 200 mijë euro, kurse nga 200 mijë euro të tjera janë paraparë edhe për vitin 2022 dhe 2023, që në përgjithësi i bie 600 mijë euro.

Qeveria e Kosovës në fund të muajit tetor ka miratuar Projektbuxhetin për vitin 2021. Përqendrimi i fondeve në projekte të mëdha publike, kryesisht infrastrukturë rrugore, është vendim i gabuar në këtë periudhë krize, thotë Krasniqi duke shtruar se të hyrat buxhetore gjatë këtij viti dhe vitin e ardhshëm mund të zvogëlohen. "Qeveria duhet të përkrahë bizneset, prodhimin vendor, eksportin sepse kemi të bëjmë me një gjendje jashtëzakonisht të keqe në raport eksport-import. Ne vazhdimisht kemi kërkuar që qeveria prioritet të ketë përkrahjen e bizneseve përmes mbështetjes së bizneseve private nga edhe mbushet buxheti", thotë ai.

Të Kosova mos të futet edhe në një katastrofë edhe më të rëndë të zhvillimit ekonomik sepse efektet e pandemisë do barten edhe vitin tjetër", tha Krasniqi përmes "Radion Evropa e Lirë". Humbjet e deritashme në ekonominë e Kosovës, që nga muaji mars i këtij viti, të shkaktuara nga pandemia, sipas përfaqësuesve të bizneseve, vlerësohen të janë një miliard euro, kurse deri në fund të vitit mund të humbin mbi 30 mijë vende pune. Kërkohet menaxhim efektiv i mjeteve buxhetore. Edhe Mejdi Bektashi, profesor në Universitetin e Prishtinës, thekson përmes "Radion Evropa e Lirë" se ekonomia po përballet

me emergjencë, bizneset për shkak të pandemisë kanë zvogëluar numrin e punëtorëve, rrjedhimisht po rritet edhe shkalla e varfërisë. Ekonomia në këtë situatë, sipas tij, ka nevoje përmes përkrahje financiare përmes bizneset dhe rastet sociale. "Qeveria duhet të krijojë rezerva financiare me qellim që të krijojnë rezerva përmes ndihmuar bizneset që janë para falimentimit, ndoshta gjysma e tyre nuk mund të funksionojnë vitin e ardhshëm. Por, mos të harrojmë se në Kosovë kemi një situatë shumë të vështirë sociale, kështu që kërkohet menaxhim i mirë", thekson Bektashi.

Qeveria nuk shqetësohet përmes zhvillimit ekonomik

Por, Skënder Krasniqi thotë se qeveria nuk po shqetësohet përmes zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve. "Me pasojat e pandemisë bizneset do përballen edhe vitin e ardhshëm. Kështu që qeveria është dashur të ndryshojë strategjinë, qoftë edhe duke hequr dorë nga ndërtimi i kësaj autostrade. Fokus duhet të jetë zhvillimi ekonomik, përmes mbështetjes së bizneseve private nga edhe mbushet buxheti", thotë ai. Investimet publike të financuara nga buxheti janë të nevojshme, por në këtë kohë mund të

pezullohen, thotë Bektashi. "Nëse ne shkatërrojmë ekonominë, nuk na duhen autostradat dhe as objektet infrastrukturore. Prandaj, qeveria duhet të fokusë sa më shpejtë në rimëkëmbjen dhe në ndihmë të bizneseve. Jo, vetëm qeveria po edhe shumë komuna të veprojnë përmes zhvillimit ekonomik", thekson Bektashi. Autostrada që lidh qytetet Istog - Pejë - Deçan - Gjakovë dhe Prizren, ishte projektuar nga qeveria e kaluar e udhëhequr nga ish-kryeministri, Ramush Haradinaj. Kjo autostradë llogaritet si një ndër më të gjata në territorin e Kosovës, me 91 kilometra gjatësi. Infrastruktura rrugore kryesisht ka mbizotëruar investimet në Kosovë këto vitet e fundit. Përveç autostradave, investime të mëdha janë përqendruar edhe në ndërtimin e rrugëve lokale e magjistrale. Përqindja më e madhe e buxhetit të Kosovës zakonisht është ndarë pikërisht përmes zhvillimit ekonomik, përmes mbështetjes së bizneseve private nga edhe mbushet buxheti", thotë ai. Investimet publike të financuara nga buxheti janë të nevojshme, por në këtë kohë mund të

Odat ekonomike kundër mbylljes totale



PRISHTINË, 22 NËNTOR- Mbyllja totale eventuale po konsiderohet e rrezikshme përmes humbjen e vendeve të punës dhe falimentimin e bizneseve, duke e dërguar në këtë mënyrë vendin drejt kolapsit.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi ka thënë se nëse vihen në zbatim masat e mbylljes totale rrezikohet stabiliteti financiar i vendit në aspektin buxhetor. "Mbyllja eventuale është me

rrezik shumë të madh sepse deri tanë kemi pasur rrezik përmes vendet e punës, po ashtu edhe përmes mbylljen e bizneseve. Ndërsa, kryetari i Odës Ekonomike Amerikane të Kosovës (OEK), Arian Zeka, ka

në aspektin buxhetor po ashtu edhe atë financiar. Kjo e bënë të pashmangshëm ndonjë kolaps", ka thënë Rukiqi përmes EO. Ndërsa, kryetari i Odës Ekonomike Amerikane të Kosovës (OEK), Arian Zeka, ka

theksuar se karantinimi i Prishtinës do të kthente vendin në një situatë të rënieve së aktivitetit ekonomik, duke shtuar se rrezikon një pjesë të madhe të kompanive drejt falimentimit.

Komunat duhet të janë më përkrahëse në zhvillimin e ekosistemit të ndërmarrësisë



Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se komunat kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e politikave dhe ekosistemit të ndërmarrësisë, duke theksuar heqjen e barrierave të të bërit biznes në nivel lokal, të shërbyerit si avokues të bizneseve lokale pranë institucioneve qendrore, por edhe përmes ndarjes së fondeve për nxitje të ndërmarrësisë, e cila mes tjerash do të shërbente edhe si motivues për qëndrimin e të rinjve brenda Kosovës

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 NËNTOR- Me diskutimin e rolit të komunave në zhvillimin e ekosistemit të ndërmarrësisë janë përmbyllur aktivitetet e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë në kuadër të Javës Globale të Ndërmarrësisë që organizohet nën udhëheqjen e Qendrës së Inovacionit të Kosovës.

Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se komunat kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e politikave dhe ekosistemit të ndërmarrësisë, duke theksuar heqjen e barrierave të të bërit biznes në nivel lokal, të shërbyerit si avokues të bizneseve lokale pranë institucioneve qendrore,

por edhe përmes ndarjes së fondeve për nxitje të ndërmarrësisë, e cila mes tjerash do të shërbente edhe si motivues për qëndrimin e të rinjve brenda Kosovës.

Ai ka folur edhe për rolin e vyshtëm të Qendrës së Inovacionit (ICK) në mbështetje të ndërmarrësve të rinj, duke theksuar se aktivitetet e kësaj organizate kanë marrë edhe jehonë pozitive anembanë botës. Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka thekura se për zhvillimin ekonomik në nivel lokal brenda kësaj komune janë identifikuar fushat ku Prizreni ka përparësi strategjike, siç është turizmi, prodhimtaria, bujqësia dhe shërbimet kreative.

Tutje, ai foli për rëndësinë e Parkut të Inovacionit dhe

Trajnimeve në Prizren, si dhe potencialin që ka kjo zonë në nxitjen e ndërmarrësisë së të rinjve por edhe investimeve në përgjithësi.

Po ashtu Haskuka ka folur edhe përfunksionalizimin e qendrës së vetme të shërbimeve 'one-stop-shop' me qëllim të lehtësimit të të bërit biznes. Ndërsa duke folur për kapitalin njerëzor, Haskuka i këshilloi të njëjtë të zhvillojnë aftësitë profesionale sipas nevojave të tregut.

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka përmendor planin strategjik të kësaj komune për zhvillim socio-ekonomik, i cili në fokus ka ndërmarrësinë dhe rritjen e punësimit të grave.

Ai gjithashtu ka folur për strukturën dhe zhvillimin e bizneseve në këtë komunë, duke

theksuar politikën e 'tarifës zero' përmes të cilës janë ulur të gjitha taksat përvèç tatimit në pronë, gjë që krijon një lehtësim të madh për veprimtaritë e bizneseve lokale. Haziri ka theksuar se gjatë pandemisë por edhe më tej, të rinjtë e Gjilanit do të mbështeten në sektorë si ai i teknologjisë e zejtarisë ndërsa shtoi se po punohet edhe rreth riaktivizimit të inkubatorit të biznesit dhe zhvillimit të zonave ekonomike brenda kësaj komune.

Ai ka shthuar se po punohet rreth eliminimit të procedurave burokratike administrative, ndërsa sipas tij, është e rëndësishme që të rritet atraktiviteti i vendit për të rinjtë, dhe krijimi i mundësive dhe lehtësirave për investime në Kosovë.

Shpend Lila, menaxher i trajnimeve, marrëdhënieve me publikun dhe aktiviteteve në Qendrën e Inovacionit të Kosovës (ICK), theks të veçantë i dha nevojës për krijimin e hapësirave rekreative, multifunksionale, të qasshme për publikun e gjërë për zhvillimin e aktiviteteve të natyrës së ndërmarrësisë dhe inovacionit. Lila gjithashtu shprehu

shqetësimin për shuarjen e Ministrisë së Inovacionit, e cila do të shërbente si një adresë e vetme për zhvillimin e ndërmarrjeve dhe bizneseve startup, ndërsa për të siguruar zhvillim të mirëfilltë ekonomik dhe promovim të sektorëve me potencial, ai rekomandoi krijimin e inkubatorëve specifik sipas profileve të komunave, në mënyrë që të decentralizohet fokusi në kryeqytet dhe zhvillimi të jetë i barabartë.

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka shënuar Javën Globale të Ndërmarrësisë me gjithsejtë 16 aktivitete virtuale në të cilat kanë marrë pjesë rreth 50 panelistë dhe me një audiencë prej rreth 40,000 personash, ndërsa temat e diskutimeve kanë përfshirë edukimin, gjithëpërfshirjen, politikat dhe ekosistemin e ndërmarrësisë.

Një numër aktivitetesh janë organizuar në partneritet me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Agjencinë për Zhvillimin Rajonal - Qendër (RDAC) dhe Kolegjin AAB.

FMN-ja: Ekonomia botërore do të tkurret me 11 trillionë euro

PRISHTINË, 22 NËNTOR- Prodhimi i Brendshëm Bruto botëror do të bie ndjeshëm, ku të gjithë ekspertët pajtohen për këtë. Ka qasje të ndryshme vetëm në masën e tkurjes ekonomike dhe perspektivat afatmesme për një kthim në rritje. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) pret që ekonomia botërore të tkurret me 11 trillionë euro. "Ky është

recesioni më i madh që nga përplasja financiare e vitit 1929", ka pohuar një ekonomist kryesor i FMN-së, duke shtuar se "asnje vend nuk do t'i mbijetojë krizës". Si rezultat i kritës ekonomike, deficitet buxhetore në raport me PBB-në do të arrijnë pikën më të lartë që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore. Sipas FMN-së, masat përmeshtetjen e zhvillimit

duhet të merren dhe vendet e pasura duhet të ndihmojnë edhe më të varfrit. Përvèç kësaj, masa të rrepta shtrënguese duhet të merren pas përfundimit të pandemisë për të zgjeluar borxhin publik.

FMN-ja vendos recesionin botëror në 4.9 për qind, ndërsa për 2021 parashikon një rimëkëmbje graduale prej 5.4 për



qind. Sidoqoftë, këto vlerësimë janë të vlefshme vetëm me kusht që të mos ketë një valë tjetër

pandemie me imponimin e bllokimeve të reja, të cilat do të forconin çdo kthim në zhvillim.

PDK-ja kërkon të zbatohet vendimi që liron nga pagesa qytetarët që shfrytëzojnë trafikun urban

PRISHTINË, 22 NËNTOR (ER)- Dega e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Prishtinë, ka kërkuar që të nisë zbatimi i vendimit për lirim nga pagesa për qytetarët që shfrytëzojnë trafikun urban. Asamblisti i PDK-së në Prishtinë, Leutrim Retkoceri, në një konferencë për medie ka thënë se propozimi i partisë së tij është

vendim i marrë nga 11 nëntori. Ai ka thënë se kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti e ka për obligim zbatimin e vendimeve të Kuvendit Komunal. "Qytetarët sot më shumë se kurrë kanë nevojën për ndihmë, komuna ka të shpenzuar vetëm 60 për qind të buxheti komunal, dhe kjo është një arsy që të zbatohet ky

vendim", ka thënë Retkoceri. Ndërsa nënkyetari i PDK-së në Prishtinë, Ilirik Musliu, ka thënë se shfrytëzimi i trafikut urban do të ndikojë në uljen e ndotjes së ajrit. Ndërkohë, propozimin e PDK-së e kanë mbështetur dhe miratuar edhe asamblistët tjerë në Kuvendin Komunal të Prishtinës.



Diskutohet draftrregullorja për parkingjet e qytetit të Prizrenit



PRIZREN, 23 NËNTOR (ER)- Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Beni Kizolli ka zhvilluar një takim punues me inxhinierët e komunikacionit rrugor, të cilët janë edhe mësimdhënës

në Shkollën e Mesme të Lartë Teknike "11 Marsi" në Prizren. Në këtë takim, drejtori Kizolli dhe inxhinierët e komunikacionit rrugor kanë diskutuar rreth përgatitjes së draftrregullores për parkingjet

e qytetit të Prizrenit. Me këtë rast, drejtori Kizolli ka bërë me dije se në vazhdim do të organizohen takime edhe me grupet punuese, me të cilat do të bëhet plotësimi i kornizës përbajtjesore të kësaj draftrregullore.

Asfaltohen fushat sportive në Gllamnik

PODUJEVË, 22 NËNTOR (ER)- Nënkyetari i Komunës së Podujevës, Nexhami Rudari, ka vizituat fshatin Gllamnik, për të parë nga afër punimet në asfaltimin e fushave të hapura sportive. Me këtë rast, Rudari ka thënë se shumë shpejtë

edhe të rinjtë e Gllamnikut do kenë fushat sportive ku do t'i shfrytëzojnë për aktivitetet e tyre.

Ky projekt është investim i bërë nga Komuna e Podujevës, respektivisht nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.



Mitrovica, komuna më e varfër në Kosovë

Mitrovicë, 22 nëntor (ER)- Komuna e Mitrovicës është duke u konsideruar si komuna më e varfër në Kosovë. Një gjë e tillë është pasqyruar në statistikat e Agjencisë së Statistikave e Kosovës. Sipas kësaj agjencie, numri i familjeve që kanë kërkuar ndihmë sociale ka shënuar rritje në tremujorin e fundit. 24 mijë e 496 familje janë

pjesë e ndihmës sociale. Gjatë muajve prill - qershor numri i familjeve që kanë kërkuar ndihmë sociale ishte 24 mijë e 339. Komuna me më së shumti familje që përfitojnë nga skema e ndihmave sociale është Mitrovica. Në këtë komunë 2 263 familje përfitojnë nga skema e ndihmave sociale.



Shpërndahen 400 koshere bletësh për fermerët ferizajas

FERIZAJ, 22 NËNTOR (ER)- Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Burim Bajrami, bashkë me zyrtarët e kësaj drejtorie, kanë bërë shpëndarjen e 400 koshereve të bletëve për 131 përfitues, prej tyre pesë koshere janë ndarë për shkollën e agrobiznesit "Zenel Hajdini" në Ferizaj. "Janë këto

subvencionet e vazhdueshme, si asnjëherë më parë që po shpërndahan nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë, të cilat po përmirësojnë dukshëm mirëqenien e bujqve e fermerëve ferizajas, përmes mekanizmave bujqësor, subvencionimit me kultura bujqësore e të tjera për të cilat

po përfitojnë bujquit e fermerët ferizajas", ka njoftuar Komuna e Ferizajt. Sipas këtij njoftimi, drejtori Bajrami ka thënë se ky aksion, tashmë është bërë i shpeshtë me të vëtmin qëllim, rritjen e përkrahjes për veprimtarinë e bletarisë, një numër të madh të kultivuesve të së cilës ka Ferizaj.



SHTËPIA E VERDHË - VMA



Shkruan: Ragip SHALA

Në qershori të vitit 1999, me luftën e UÇK-së, Kosova u çlirua nga terrori i luftës konvencionale serbe, por nuk u çlirua nga terrori i luftës speciale të shërbimeve inteligjente të UDB-së dhe KOS-it. Terrori i luftës konvencionale serbe zë fill me spastrimet etnike në krahinat e Toplicës dhe Kosanicës, kurse vazhdon të rritet në mes dy luftërave botërore dhe kulmoi me krimet e gjenocidit gjatë luftës në vitet 1998/99. Ndërsa terrori i luftës speciale vazhdon ta terrorizojë Kosovën në forma dhe metoda më të sofistikuara nga lëmi i kësaj lufte. Serbia me propagandë përmes mjeteve të komunikimit masiv, librave, kinematografisë dhe diplomacisë, ka arritur ta ngujojë dhe ta kryqëzojë Kosovën në arenën ndërkombëtare.

Dinakëria serbe përmes luftës speciale ka arritur të shpifë aq mjeshtërisht kundër UÇK-së saqë edhe Dick Marty, i dehur nga "poklloni" i shlivovicës serbe, "hëngri sapunin për samun"! E tërë vepримтарia e luftës speciale

E tere veprimtaria e lutes speciale serbe përmes propagandës ka kulmuar me trillimin e "Shtëpisë së Verdhë" në malet e Kukësit, si një "poliklinikë" në të cilën gjoja janë kryer transplantime të organeve njerëzore. Nën ndikimin e shërbimeve inteligjente serbe, Dick Marty hartoij një raport me të cilin denoncoi UÇK-në për "transplantim" dhe "trafikim organesh njerëzore" në Këshillin Evropian që rezultoi me themelimin e Gjykatës Speciale me një fond prej 350 milionë dollarësh. Duke u bazuar në definimet e shkencave të mjekësisë se: Ç'është transplantimi? Cilët kirurgë mund të operojnë? Në çfarë rrethanash? Me çfarë pajisje? Në cilat klinika? Atëherë na shpalosen dy klinika transplantësh: Njëra në "Shtëpinë e Verdhë" në Kukës, tjetra në Ratainic fë Beogradit

Batajnac te Beogradit. E para është "klinikë" fiktive e Dikç Martyt, kurse e dyta është klinikë reale e gjeneralëve vrastarë serbë: R. Mlladiqit, N. Pavkoviqit, V. Llazareviqit, S. Llukiqit në krye me Millosheviqin, të gjithë këta gjakatarë të dënuar nga Gjykata e Hagës për krimet lufte në Kosovë dhe Bosnie Hercegovinë.

“Klinika” e Dick Martyt në “Shtëpinë e Verdhë” në Kukës është një objekt banimi me ndërtim tejet të vrazhdë, pa rrugë, pa rrymë, pa ujë në majë të bjeshkës, në të cilin “klinikë”, sipas Martyt, janë “transplantuar organe” serbësh që pastaj janë “trafikuar” përmes portit të Durrësit dhe aeroportit të Tiranës. Kjo “klinikë” në “Shtëpinë e Verdhë” si e tillë, është një absurd

që vret jo vetëm në ndërgjegjen racionale të "shlivovicqanit" Marty, por dhe të Asamblesë Parlamentare të Këshillit Evropian. Ky absurd do të trokasë gjithsesi në dyer të drejtësë për terrorin psikologjik ndaj popullit të Kosovës. E dyta shtëpi e verdhë ndodhët në Batajnica të Beogradit. Nuk është klinikë absurdi, por është reale dhe hyn ndër klinikat më moderne në kontinentin evropian. Kjo "Shtëpi e Verdhë", VMA (Vojna Medicinska Akademija) Akademia e Mjekësisë Ushtarake, është departament i Ministrisë së Mbrojtjes të Qeverisë së Serbisë. Përbëhet prej 30 klinikave dhe 20 instituteve shkencore për hulumtime të ndryshme në lëmenj të ushtarakë. Që nga viti 1978 në këtë qendër poliklinike ushtarake janë praktikuar transplantimet e organeve njerëzore, prandaj për këtë konsiderohet një ndër klinikat e para në Evropë. Në këtë qendër mjekësore ushtarake janë formuar mijëra kirurgë ushtarakë dhe civilë të cilët kanë pasur për ligjërues edhe shkencëtarin dhe kirurgun e famshëm për transplantime, prof. dr. Vladimir Petroviq. VMA (Vojna Medicinska Akademija) Akademia e Mjekësisë Ushtarake në Batajnica të Beogradit, për dallim të "Shtëpisë së Verdhë" në Kukës, është një metropol në vete i kompletuar me pajisje aparaturash më moderne dhe personel mjekësor më të specializuarit, infrastrukturë adekuate për transplantime, në të cilën për çdo muaj kryhen disa dhjetëra operacione transplantimesh me organe njerëzore: zemra, veshkë, mëlçi, të tëra këto në mënyrë të "ligjishme"!?

hapë portën e ferrit mbushur me krimet më të tmerrshme, krimet më makabre në VMA të Beogradit, poliklinikë kjo në të cilën u janë shkulur dhe trafikuar organet mijëra personave jo vetëm gjatë luftës në Bosnjë dhe Kosovë. VMA e Batajnica së Beograd është industri kriminale, emblemë e kriminalitetit më të organizuar në nivel global me protagonistë gjeneralë, politikanë, mjekë, klerikë që për decenje kanë kryer këto krimet për "ligjishme". Në zbulimin e këtyre krimave janë së paku tri pista: a) "Vetëvrasjet" e Rekrutëve Shqiptarë në APJ, b) Shoqata e Prindërve të Foshnjave të Humbura (Udruzenje Roditelja Nestalih Bebe), c) Të "Zhdukurit" shqiptarë gjatë luftës në Kosovë 1998/99.

"Vetëvrasjet" e rekrutëve shqiptarë gjatë shërbimit ushtarak në APJ kanë ndodhur pas Pranverës Republikane të '81-s, sidomos në prag të shpërbërjes së RSFJ-së.

Janë mbi 100 rekrutë shqiptarë që gjoja kanë bërë "vetëvrasje" në kazemat ushtarake anembanë RSFJ-së. Çuditërisht pas "vetëvrasjeve" të gjithë atyre u janë bërë ekspertizat mjekoligjore në VMA të Batajnica, nga aty pastaj familjarët e ngushtë kanë tërhequr arkivolet e myllura hermetikisht, duke i varrosur nën përcjelljen e policisë ushtarake? Këto krimet të padënuara të gjeneralëve serbë kërkojnë drejtësi dhe adresa të zbardhjes së tyre, që nuk është askund tjetër pos në "Shtëpinë e Verdhë" të Batajnica së Beograd. Shoqata e Prindërve të Foshnjave të Humbura në Serbi është themeluar në vitin 2005, kryetari i së cilës është Vladimir Qiqareviq, e cila shtrihet në tërë Serbinë

Karla del Ponte është "përbiruar për birë të gjilpërës" për t'i vërtetuar shpifjet e terrorit të luftës speciale serbe. Në mungesë provash, Gjykata Penale Ndërkombëtare ka ndërpërë hetimet ndaj "klinikës" së Martyt në "Shtëpinë e Verdhë" në Kukës. Shërbimeve inteligjente serbe, shpifjeve tejet të sofistikuara të tyre nuk i ndihmuani as 350 milionë dollarët e taksapaguesve evropianë për t'ia lënë kopilin te dera "UÇK-së, me sajesën e klinikës" së Dick Martyt. Përkundrazi, "Shtëpia e Verdhë" në Kukës tanj është celësi që do ta (Vojvodinë) dhe, së fundmi, në Bosnjë dhe Maqedonië e Veriut. Numëron rreth 10 000 anëtarë, prindër të foshnjave të zhdukura gjatë disa decenieve të kaluara. Sipas të dhënave të kësaj shoqate, rezultojnë 30 000 foshnja të humbura, që janë rrëmbyer nëpër spitale gjinekologjike, duke i mashtruar prindërit se "u ka vdekur foshnja"?! Që nga viti 2013 në Gjykatën për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, prirë nga Zorica Jovanoviç, janë paraqitur qindra padi kundër shtetit serb për foshnjat e zhdukura. Gjykata ka vendosur në

He Kakes tari eshte çelesi qe do ta zbuluar. Gjykatu ka vendosur he



Demonstrata e prindërve të fëmijëve të humbur

A photograph of a large, modern office building with a distinctive curved, multi-story facade. The building features a combination of light-colored panels and dark, horizontal cladding on its upper sections. It has several prominent wings extending from a central core. The foreground shows some overgrown vegetation and a low wall.

Spitali Ushtarak në Batajnica

favor të prindërve, duke ngarkuar shtetin serb që t'i ekzekutojë aktgjykimet. Meqë shteti serb ka vazhduar të mos ekzekutojë aktgjykimet, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës i ka kërkuar shumë herë Serbisë t'i ekzekutojë aktgjykimet, madje Këshilli i Evropës ka miratuar edhe Rezolutë për këtë çështje. Nën presion të Këshillit të Evropës, të Gjykatës së Strasburgut, Kuvendi i Serbisë më 29 shkurt 2020 ka votuar Ligjin për Foshnjat e Zhdukura. Në bazë të ligjit, shteti serb obligohet t'i kompensojë prindërit e fëmijëve të zhdukurve me nga 10 000 euro, por çështja nuk ka mbaruar këtu. Prindërit nuk duan kompensim. Ata kërkojnë të njoftohen me të vërtetën se çfarë ka ndodhur me fëmijët e tyre vendrrëmbimi i tyre. Të vrarët janë tërhequr nga vendemasakrat e Kosovës dhe bartur në Serbi, disa trupa të tyre u janë djegur në shkritisë e Zveçanit dhe Borit, disa janë varrosur ndër punishte anembanë Serbisë. Të "zhdukurit" nga kategoria e të rrëmbyerëve janë transportuar të gjallë deri në Kazermën ushtarake të Batajnicsë dhe kjo kategori e të "zhdukurve" përbën kulmin e krimeve të gjenocidit shtetëror serb ndaj shqiptarëve. Në Batajnici është deri tanë janë zbuluar 1 200 trupa të personave të "zhdukur", kurse përskaj Batajnicsë në Lumin Danubë janë zbuluar edhe 1 000 trupa në kamion ushtarak. Batajnica përbën varrin më të madh masiv të shqiptarëve të "zhdukur" për dallim nga varret e tiera masive anembanë Serbisë.

Në tetor të vitit 2020 shoqata organizoi protestë para VMA-së duke akuzuar politikanë, eprorë ushtarakë, mjekë, klerikë fetarë të shtetit serb për zhdukjen e fëmijëve të tyre, transplantim dhe trafikim organesh. Akuza e Shoqatës së Prindërve të Fëmijëve të Zhdukur shpalosi një krim të pashembullt në nivel global: vjedhjen e foshnjave të sapolindura nga lehonat, shitjen e foshnjave, transplantimet e organeve dhe trafikimin e tyre për disa dekada me radhë.

Pse gjeneralët serbë i bartën të "zhdukurit" (të vrarët dhe të rrëmbyerit) nga rajone të ndryshme të Kosovës për nënë Batajnicë, në një distancë prej 500-600 kilometrash?

Meqë domin t'i zhduknin provat e kimeve ndaj civilëve, atëherë pse nuk i varroshnin diku më afër, p. sh., në Kurshumli, Prokuple, Nishë, por nënë Batajnicë?!

Pse mbetjet mortore të të "zhdukuarve" janë kthyer me etapa, kohë pas kohë?!

Pse në formulat e identifikimit të

Të zhdukurit shqiptarë gjatë luftës në Kosovë 1998/99 përbën kapitullin më të dhimbshëm të çlirimit të Kosovës. Përbën pistën kryesore për të "aterruar" në bazën e krimit më të organizuar shtetëror serb: VMA në Batajnica të Beogradit.

Pse në formularët e identifikimit te mbetjeve mortore mungon rubrika: Koha e vdekjes. A nuk e përcakton shkenca e mjekësisë ligjore saktë, pos shkakut, edhe kohën e vdekjes?!
Përgjigjet jo vetëm nga këto pyetje, por edhe në qindra të tjera provojnë katërcipërish se në

Përderisa të vrarit civilë: fëmijë, gra, pleq, viktima të krimit të gjenocidit serb janë varrosur në varreza të Prekazit, Reçakut, Krushës së Madhe, Rezallës, Izbicës, Mejës, të "zhdukurit" një pjesë pas zhvarrojeve nga Serbia janë varrosur në Kosovë, kurse pesa tjetër e të "zhdukurve" edhe pas 21 vjëteve varret u kanë mbetur akoma tâ shqyrat.

provocojnë katërçipërsht se në Qendrën Poliklinike VMA të Batajnices në Beograd janë kryer krimet më makabre nga gjeneralët serbë. Transplantime të organeve prej të "zhdukurve" shqiptarë dhe trafikimi i tyre i "ligjshëm", mbasse edhe përtetj atlantikut.

"Shtëpia e Verdhë" nuk është në Kukës. Është në VMA të Batajnices në Beograd. Atje fshihet krimi më i rëndë më i usqantë që pas Luftës

të zbrazët. Të "zhdurat" shqiptarë: fëmijë, adoleshentë, gra, burra dhe pleq, përbëhen nga dy kategori: Të vrarët dhe të rrëmbyerit, të cilët nuk janë zhdurur në Kosovë, por në Serbi deri në 500 kilometra largësi nga vendlindja e tyre, nga rëndë, më i veçantë që pas Luftës Dytë Botërore. Krim i gjenocidit serb ndaj shqiptarëve të rrëmbyer gjatë luftës në Kosovë. "Shtëpia e Verdhë" VMA e Batajnicsës në Beograd kërkon Dick Martyn! Ku është Dick Martyn?

Nuk gabojnë favoritët



Ballkani dhe Prishtina të dielën kanë realizuar fitore me rezultat identik 4-2, ndaj Llapit, përkatësisht Trepçës '89. Fitore në këtë xhiro kanë shijuar edhe Feronikeli, Drita dhe Gjilani

EPOKA
ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Skuadra e Ballkanit të dielën e mposhti pa asnjë problem skuadrën e Llapit (4-2), duke ia thelluar edhe me shumë kritikë e rezultateve në këtë edicion garash. Skuadra e drejtuar nga Ismet Munishi ishte superiore në pjesën e parë të ndeshjes, duke realizuar katër gola. Nazmi Gripshi shënoi dy herë, kurse nga një gol e shtuan Ermal Krasniqi dhe Mirlind Daku. Në pjesën e dytë Llapi shënoi dy gola me anë të Elvis Prenci dhe Ahmed Januzi, por kjo ishte e terë që e arriti kjo skuadër në këtë ndeshje. Ballkani përforcohet në krye të elitës me 29 pikë, derisa Llapi imbetet në pozitën e parafundit me vetëm 8 pikë. Të dielën fitore me rezultat 4-2 regjistroi edhe Prishtina në përballje ndaj Trepçës '89, e cila u zhvillua në stadiumin "Fadil Vokri" në Prishtinë. Vendave iu deshën vetëm dymbëdhjetë minuta për të kaluar në epërsi me golin e Sabien Lilaj nga penalltia. Në minutën e 27-të,

Kryeziu realizon për 2-0. Në fund të pjesës së parë, Bismarek e ngushton epërsinë në 2-1. Në pjesën e dytë, Besnik Krasniqi realizoi një supergol për rezultatin 3-1, derisa Mankenda e shënoi golin e katërt për kryeqytetasit. My safirët shënuan edhe golin e dytë në përmjet Arbnor Mujës, në minutën e 71-të. Pas kësaj ndeshje, Prishtina është në vendin e katërt me 18 pikë, kurse 89-shi zë vendin e tetë me 14 pikë. Ndërsa të shtunën janë zhvilluar tri ndeshje të xhiros së 13 në Superligën e Kosovës në futboll. Drita shënoi fitore bindëse në udhëtim te Besa, derisa shënuan edhe Feronikeli e Gjilani. Kampionët në fuq e mposhten Besën me rezultat prej 4-1. Nga dy gola për skuadrën gjilanase i shënuan Betim Haxhimusa e Astrit Fazliu, kurse golin e vetëm për Besën e shënoi Krasniqi. Në Drenas, Feronikeli shënoi ndaj Arbërisë me rezultat 1-0, derisa golin e vetëm në ndeshje e shënoi Albert Dabiqaj në fund të pjesës së parë. Fitore me rezultat 1-0 ka shënuar edhe Gjilani kundër Drenicës, autor i golit të vetëm ishte Nikaq.

SUPERLICA

Ballkani - Llapi	4-2
Prishtina - Trepça '89	4-2
Besa - Drita	1-4
Feronikeli - Arbëria	1-0
Gjilani - Drenica	1-0
Tabela	

1. Ballkani	12	29 pikë
2. Drita	11	26
3. Gjilani	12	23
4. Prishtina	12	18
5. Drenica	13	18
6. Feronikeli	13	15
7. Arbëria	13	14
8. Trepça '89	13	14
9. Llapi	12	8
10. Besa	13	6

Në xhiron e radhës takohen: Drita-Feronikeli, Arbëria-Gjilani, Llapi-Prishtina, Trepça '89-Besa, Drenica-Ballkani.

Grupi A

Liria - Onix	0-0
Vushtrria - Istogu	0-1
Drenasi - Dukagjini	2-2
Vëllaznimi - A&N	0-1
Malisheva - Trepça	1-0

Grupi B

Ulpiana - KEK-u	2-0
Ferizaj - 2 Korriku	2-0
Dardana - Kika	0-2
Ramiz Sadiku - Villaznia	0-1
Vitja - Flamurtari	1-1

SHKURT

Sot finalja e Kupës së Kosovës, Llapi - Mitrovica

Sot (e hënë) në orën 13:30, në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë do të zhvillohet ndeshja finale e Kupës së Kosovës në konkurrencën e femrave, ndërmjet Llapit dhe Mitrovicës. Kjo finale i takon edicionit garues 2019/2020 dhe ishte paraparë të zhvillohej në periudhën maj-qershor, por për shkak pandemisë dhe orarit të njësuar të ndeshjeve ka qenë e pamundur të zhvillohet deri më tanë.

Dy gola dhe dy asistime nga Manaj

Sulmuesi Arb Manaj bëri një hap të rëndësishëm në karrierën në merkaton e verës, teksha kaloi nga Trepça '89, te skuadra e Ligës së Parë turke, Keciorenegucu. Aventura në Turqi po ecën shumë mirë, teksha ditën e sotme sulmuesi 22-vjeçar ka shkëlqyer me paraqitjen e tij. Në ndeshjen që skuadra e tij e fitoi 5-0 ndaj Akhisarsporit, Manaj ka shënuar dopietë golash në minutat 18' dhe 33'. Gjithashtu ai ka dhënë edhe dy asistime në golat e tjerë, fillimisht për Ekinxhi në minutën e 47' dhe për Jëllmaz në minutën e 54'. Manaj është zëvendësuar në minutën e 77-të.

Xhaka nuk është i interesuar për ofertën e Interit

Mesfushori i Arsenalit, Granit Xhaka nuk mendon largimin nga klubi pavarësisht interesimit të Interit. Xhaka në disa ndeshje të këtij edicioni ka mbetur në bankën rezervë. Thuhet se "Neurazurët" janë të hapur që ta shkëmbjnë me mesfushorin Christian Eriksen gjatë afatit dimëror, derisa "Calciomercato", raporton se 28-vjeçari nuk është i interesuar dhe do refuzojë këtë ofertë.

Lorianë Kuka fitoi medaljen e bronzës

Lorianë Kuka është medaliste e bronzës e Evropës, në kategorinë -78 kilogramë të zhudos. Ajo fitoi të bronzën në Kampionatin Evropianë Pragë 2020. Në luftën për të bronzën Lori imposhti italianen Giorgia Stangherlin me shënim të artë. Kjo është medalja e dytë e bronzës evropiane për Lorianën në dy vitet e fundit. Kosova kthehet nga Praga me dy medalje bronzi. Krahas Lorianës, të njëjtën medalje fitoi të enjten edhe Distria Krasniqi.

Besa Famgas kalon në raundin e tretë

PEJË, 22 NËNTOR - Besa Famgas e ka fituar bindshëm edhe ndeshjen e dytë të raundit të dytë të Kupës Evropiane. Të dielën në palestrën "Karagaçë" në Pejë, Besa Famgas e mposhtu

Bosna Visokon me rezultat 32:20. Ndeshten e parë, të luajtur të shtunën në Pejë, kampionia e Kosovës e fitoi me rezultat 36:18. Me dy fitore të thella, Besa kalon në raundin e tretë të Kupës

Evropiane. Janë këto fitoret më të larta të Besa Famgas në gara kontinentale. Skuadra pejane ka pretendime për të shkuar edhe më larg se raundi i tretë. Në ndeshjen e dytë rastin te Besa e kanë

fituar lojtarët e rinj, që kanë shfaqur kualitetet. Më efikasi ishte Drilon Tahirukaj me 6 gola. Pesë gola i shënoi Arbios Mushkolaj. Në raundin e tretë paraqitet edhe KH Prishtina.



Bajoku boksieri më i mirë i turneut 'Adem Jashari'

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Shpejtëm Bajoku është shpallur boksieri më i mirë i turneut ndërkombe të "Adem Jashari". Finalet e turneut të 22-të me radhë janë organizuar të dielën. "Moti nuk kemi boksuar për shkak të pandemisë. Ky çim më motivon shumë dhe besoj se do të fitojë edhe shumë tituj. Qëllimi im është që kam për të arritur kulmin", ka thënë Bajoku. Tekniku më i mirë u zgjodh Esthemes Andrey i Bullgarisë, ndërsa boksieri më fer-plej, Arsim Hetemi, nga Maqedonia e Veriut. Boksieri më i mirë i huaj u zgjodh Kimil Rusonov i Bullgarisë, ndërsa Besart Pireva u zgjodh boksieri më i mirë vendor, raporton "KP". Legjenda e boksit Aziz Salihu, themelues njëherit i turneut "Adem Jashari", është ndarë i kënaqur që është zhvilluar turneu, por pranon se ndjehet mungesa e tifozëve. "Më së pari gjëzohem që është në pyjetë turniri të cilin e kam themeluar unë 'Adem Jashari', kënaqësi dhe po i shohim shumë



ndeshje të forta, të mira.... Po boksojnë rinia aq mirë, kjo është kënaqësi. Unë po habitem nga po dalin kështu, në këtë virus i cili na mbyti... Unë mendojë që duhet me iu ndihmu shumë boksit. Ju po e shihni që krejt shtetet që janë nga tre, katër apo pesë muaj shkojnë nëpër përgatitje, kurse ne me dhjetë ditë shkojmë boksojmë në turnire. Unë po habitem se si po boksojnë me këta të huajtë dhe po fitojnë", ka thënë Salihu. "Është

kënaqësi kur i ke tifozët tuaj, je mësuar. Si përparran unë e di tri herë që e kam mbajtur turneun 'Adem Jashari' i kam pasur nga 7000 - 8000 veta, ishte diçka fenomenale. Ndoshja ky virus tash shkon dhe bëhet më mirë. Boksi për mua është numër një në të gjitha sportet", ka deklaruar Salihu. Në turneun e sivjetmë kanë marrë pjesë boksierë nga Bullgaria, Zvicra, Sllovakia, Maqedonia e Veriut, Malit të Zi dhe Shqipëria.

Marmarinos: Nuk ka ndeshje të lehta, japim maksimumin nga vetja

PRISHTINË, 22 NËNTOR - Basketbollistët e Kosovës po vazhdojnë përgatitjet para udhëtimit në Bratislavë, ku do të zhvillojnë dy ndeshjet në kuadër të parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2023. "Dardanët" janë të karantinuar për shkak të situatës me pandeminë. Stërvitjet po udhëhiqen nga përzgjedhësi Christos Marmarinos, i cili ka folur përrnjë e përgatitjeve. "Stërvitjet po shkojnë shumë mirë. Pandemia na ka shkaktuar probleme sikur çdo ekipi tjetër dhe po mundohemi të përgatitemi në mënyrën më të mirë të mundshme. Jemi duke bërë planet për ndeshjet ndaj Sllovakisë dhe Islandës dhe do të mundohemi që këto plane t'i zbatojmë", është shprehur Marmarinos përfaqen zyrtare të FBK-së. Kosova më 26 nëntor do të ndeshet me Sllovinë, kurse dy ditë më pas me Islandën. "Do të jenë ndeshje të



vështira. Në garat ndërkombe të nuk ka ndeshje të lehta. Nuk presim ndeshje të lehta. Sllovakia ka gjatësi më të madhe se ne, por duhet të adapaktohem dhe të paraqitemi në mënyrën më të mirë të mundshme. Ne kemi mundur Islandën një herë dhe sigurisht se mund ta bëjmë përsëri nëse jemi të fokusuar maksimalisht. Sigurisht

se ajo që mund të garantojmë është angazhimi ynë maksimal", ka shtuar përzgjedhësi i Kosovës. Kosova nga dy ndeshje, ka shënuar dy fitore, duke mundur Islandën dhe Luksemburgun për të qenë liderë e grupit, kurse në muajin shkurt të vitit të ardhshëm do të përballet me Sllovinë dhe Luksemburgun.

Pensionohet Pazzini

Sulmuesi italian Giampaolo Pazzini është tërhequr nga futbollisti e ka bërë publike lamtumirën e tij,

pas 17 sezonesh, me një postim të gjatë në "Instagram". "Përshtendetje futboll, kanë kaluar më shumë se 30 vite

qëkur jemi njohur", ka shkruar "Pazzo" që në sezonin e kaluar ka luajtur te Verona. "Isha një fëmijë herën e parë që kam

shtrënguar një top mes duarve dhe nga ai moment është bërë një mik i pandashëm për mua. Isha një fëmijë si shumë të tjerë,

me një jetë përpara dhe mijëra endra në sirtar që shpresonte të bëhej një ditë një futbollist i Serisë A", ka shtuar Pazzini.

SHKURT

Mullerit i dhemb turpërimi nga Spanja: Jam gati të rikthehem në kombëtare

Sulmuesi i Bayern Munich, Thomas Muller, ka thënë se është i gatshëm të rikthehet në Kombëtaren e Gjermanisë, nëse trajneri Joachim Low ndryshon mendje dhe vendos ta thërras, pas humbjes historike 6:0 që ia shkaktoi Spanja në Ligën e Kombeve. Ylli i Bayernit foli për "Sky Sport Germany" rrëth dhimbjes që e kishte ndier pas turpit që Spanja ia shkaktoi Gjermanisë. "Natyrish se të dhemb. Natyrish se vuan për bashkëlojtarët në klub, për lojtarët që i njeh, me të cilët ke luajtur dhe po ashtu përfifozi", ka thënë Muller. "Siç kam thënë, asnjëri nga ne nuk kemi dhënë dorëheqje nga Kombëtarja", ka shtuar Muller.

Reali nuk e dëshiron rikthimin e Ronaldos

Real Madridi nuk është duke konsideruar mundësinë ta rikthejë në skuadër sulmuesin Cristiano Ronaldo. Portugezi u largua nga "Santiago Bernabeu" si golashënesi numër një, pastaj iu bashkua Juventusit në vitin 2018. Sipas "Marca", Ronaldo është i interesuar për rikthimin të Reali, ose së paku largimin nga Juventusi, që gjithashtu janë të hapur ta lejojnë të largohet shkaku i pagesave të larta. 35-vjeçari është duke vazduar të shkëlqejë në Seria A dhe pëlqehet nga gjiganti francez, PSG. Sidoqoftë, Reali nuk do ta rikthejë në skuadër lojtarin dhe ribashkimi mund të realizohet vetëm nëse në të ardhmen lojtari bëhet trajner.

Guardiola: Dua që Messi ta përfundojë karrierën te Barcelona

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola ka deklaruar se dëshira e tij është që Leo Messi të përfundon karrierën në skuadrën e Barcelonës. Kohët e fundit është folur për një transferim të argjentinasin nga Manchester City në afatin kalimtar të janarit. "Ai është një lojtar i Barcelonës dhe nëse doni të dini mendimin tim, unë kam një mirënjohje të jashtëzakonshme për Barcelonën, për gjithçka që ata bënë për mua. Unë dua që ai ta përfundojë karrierën te Barcelona. Kjo është dëshira ime. Por, unë nuk e di se çfarë do të kalojë nëpër kokën e tij kur t'i përfundojë kontrata", ka thënë Guardiola.

Zidane konfirmo se Isco nuk largohet nga Reali

Trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane u mbyll dyert të gjitha skuadrave të interesuara për Iscon. Mesfushori spanjoll, ka pasur pak minuta në këtë sezoni dëshjetë që kanë aluduar shumë lajme, lidhur me largimin e mundshëm të tij nga "Los Blancos" që në mercaton e janarit. Gjithsesi për të shuar këto zëra ka menduar trajneri Zidane, i cili në një intervistë pas ndeshjes ndaj Villarealit, ka theksuar se Isco nuk do të largohet nga Reali pasi vazhdon të mbetet një element shumë i rëndësishëm për skuadrën.

Nga motoja e Adem Demaçit „Jo atyne që janë trima me ngrehë gishtin e krimit, por atyne që janë burra me shtri dorën e pajtimit“, të shprehur në romanin „Gjarpjt e gjakut“, e deri te falja e 1169 gjaqeve, 477 plagosjeve dhe 865 ngatërrresave, autori i kësaj vepre me vlera të shumëfishta nxjerr përparrë lexuesit përpjekjet e jashtëzakonshme për ta çliruar popullin shqiptar nga gjarpërjinjtë e vërtetë, si parakushtet për një mobilizim të përgjithshëm për çlirimin kombëtar.

Bardhyl Mahmuti, politolog

Atje ku nuk ka thjeshtësi, nuk ka as madhështi, thotë një kryepenë botërore. Një nga të pesë nismëtarët autentikë të Lëvizjes së Pajtimin të Gjaqeve (1990-1991) që preferuan thjeshtësinë për madhështinë kombëtare, është autor i këtij libri të vonuar tridhjetë vjet, Lulëzim Etemaj. Kjo lëvizje na transformoi në një shkallë më të lartë qytetërimi. Me pajtimin, unititetin dhe solidaritetin që solli ajo, krijoji, në të vërtetë, parakushtet përfundimtare, falë këtij boshti qytetëruesh dhe drejtimit të saktë geopolitik.

Muhamed Mavraj, publicist

LËVIZJA E PAJTIMIT TË GJAQEVE
NË KOSOVË (1990-1991)

LULËZIM ETEMAJ



LËVIZJA E PAJTIMIT TË GJAQEVE
NË KOSOVË
(1990-1991)

ISBN 978-9951-780-24-7

9 789951 780247



“A po shkruan Barney?”
“Ta merr mendja. Shkruaj gjithë kohën e lume”.
“A nuk ta ndërpresin punën adhuruesit?”
“Jo, ore, ngandonjëherë femrat më gjejnë, ama ato nuk qëndrojnë gjatë”.
“A po të shiten librat?”
“Po marrë çeqe nga të drejtat e autorit”.
“Cila është këshilla juaj për shkrimitarët e rinj?”
“Pini, qini dhe pini shumë cigare”.
“Cila është këshilla juaj për shkrimitarët e vjetër?”
“Në qoftë se ende jeni gjallë, nuk keni nevojë përkurfarë këshille”.
“Çka ju shtyn të shkruani poezi?”
“Çka ju shtyn juve të dhjesni?”
“Çka mendoni për Reaganin dhe papunësinë?”
“S’ë çaj kokën as për Reaganin e as për papunësinë. E gjithë kjo më mërzit. Sikur fluturimet në gjithësi dhe Super Bowl”.
“Atëherë për çfarë merakoseni?”
“Për femrat moderne”.
“Për femrat moderne?!”
“Po, se ato nuk dinë si të vishen. Këpucët i kanë tmerrësisht të këqija”.
“Çfarë mendoni për emancipimin e gruas?”
“Sapo të janë të gatshme të merren me larjen e automobilave, t’i lëvroat arat, t’i ndjekin ata dy tipat që e plaçkitën dyqanin e pijeve, apo t’i pastrojnë kanalizimet e ujërave të zeza, kurdo që të janë të gatshme që bombat në ushtri t’ua hedhin armiqve si sisët në ajër, unë jam i gatshëm të rri në shtëpi dhe t’i laj enët dhe të mërzitem duke i mbledhur fijet nga qilimi”.


(Fragment nga tregimi “Emancipimi i gruas”)

4.99 €

ISBN 978-9951-780-19-3

9 789951 780193

Charles Bukowski • Emancipimi i gruas



CHARLES BUKOWSKI
EMANCIPIMI I GRUAS
Përktheu: Fadil Bajraj



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
 Mbrrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshepejte

RESTAURANT
SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

P R I S H T I N Ë

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Ylli B Reisen" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70192337
- Jap banesë me qira afër 60 m², katër III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplekt, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m², me inventar të komplektuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pagesë sepsë shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muhammed Fejza", banesa është 70 m² dhe i plotëson të gjitha kushtet, katër dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muhammed Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përboll "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m², katër dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpianë katër i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana katër i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalini më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", katër tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783
- Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, katër -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.



An advertisement for RC Cola. At the top, the RC logo is displayed with the text 'ROYAL CROWN' above it. Below the logo is a yellow box containing the text 'ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS'. On the left, there is a section titled 'Quality & Sales Award Recipients' with the note '[Listed in alphabetical order]'. A list of award recipients is provided, each preceded by a star symbol. On the right, there are images of a blue RC Cola can and a dark plastic bottle of RC Cola. The background is dark blue.